



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2024:230678

Datë: 24.12.2024

Numri i dokumentit: 06646863

ARJ.nr.279/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Muhamet Rexha dhe Zenel Leku anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në çështjen juridike sipas padisë së paditësit-propozuesit, “I.F”., me seli në P., Rr. ”.....”, nr ..., me numër të regjistrimit .....-, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson, Zyra e Avokatëve “.....&.....”, me seli në P, Rr. “.....” nr ....., avokat Taulant Hodaj, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Organizata Jo Qeveritare, me seli në P., me bazë juridike anulimin e aktit administrativ – vendimit të paditurës, nr.ref.14-57-13/2024 të datës 24.07.2024, me kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditësit-propozuesit, parashtruar përmes të autorizuarit të tij, kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.832/2024, të datës 08.10.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 23 Dhjetor 2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësi-propozuesi, “I.F” me seli në P., kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit- Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.832/2024 të datës 08.10.2024.

**A r s y e t i m**

Me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit- Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.832/2024 të datës 08.10.2024, I.Aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës/kundër propozueses, Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Organizata Jo Qeveritare, e datës 02.09.2024. II. Ndryshohet - Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.3520/2024, të datës 06.09.2024. III. Refuzohet propozimi i paditësit/propozuesit, “I.F”., me seli në P., me të cilën ka kërkuar shtyrjen

e ekzekutimit të vendimit me nr.ref.14-57-13/2024 të datës 24.07.2024, të paditurës, Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Organizata Jo Qeveritare, me seli në Prishtinë, derisa gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor.

Kundër aktvendimit të lartë cekur të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, paditësi-propozuesi, përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor në Gjykatën Supreme parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, me propozim që të: APROVOHET si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe të NDRYSHOHET Aktvendimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr.832/2024 të datës 08.10.2024, ashtu që APROVOHET kërkesa e paditësit-propozuesit IPKO, Foundation, me numër të regjistrimit ....., me seli në Rr. “.....”, nr....., ..... P., për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit. II. SHTYHET ekzekutimi i vendimit me nr.ref.14-57-13/2024 i datës 24.07.2024, të nxjerrë nga Departamenti për OJQ, Ministrisë e Punëve të Brendshme, deri në vendosjen e këtij konflikti administrativ me vendim përfundimtar gjyqësor..

Gjykata Supreme në përputhje me nenin 53 të LKA-së mbajti seancën, vlerësoi pretendimet e paraqitura në kërkesë, ekzaminoi aktvendimin e kontestuar të gjykatës së shkallës së dytë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, me vendimin e kontestuar të të paditurës-kundërpropozueses Ministria e Punëve të Brendshme - Departamenti për Organizata Jo Qeveritare, I. Revokohet Statusi për Përfitim Publik i Organizatës Joqeveritare “I.F”., nr. regjistrimit ....., dhe nr. i statusit për Përfitim Publik ....-., e cila ka dështuar të dorëzojë Raportin Vjetor të kompletuar për vitin 2023, brenda afatit ligjor të paraparë me nën paragrafin 6.1 dhe 6.2 të paragrafit 6 dhe nën paragrafin 8.1 të paragrafit 8 të nenit 38 të Ligjit Nr.06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare. II. Organizatës Joqeveritare të cilës i është revokuar Statusi për Përfitim Publik nga pika I (një) e këtij vendimi, është e detyruar që në mënyrë retroaktive për periudhën për të cilën ka dështuar të kompletojë Raportin Vjetor për vitin 2023, t’i kryejë të gjitha detyrimet sipas legjislacionit në fuqi. III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e pranimit nga pala.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me aktvendimin A.nr.3520/2024, të datës 06.09.2024, ka vendosur si në vijim: I. Aprovohet kërkesa e paditësit “I.F”., me seli në P., Rr.”.....”, nr. ..., me numër të regjistrimit .....-., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Zyra e Avokatëve “Hodaj&Partners” me seli në Prishtinë, Rr.”.....” nr....., për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit. Në pikën II. Shtyhet ekzekutimi i vendimit me nr.ref.14-57-13/2024 i datës 24.07.2024 i Ministrisë së Punëve të Brendshme-Departamenti për Organizata Jo Qeveritare me seli në Prishtinë, deri në vendosjen e këtij konflikti administrativ me vendim përfundimtar gjyqësor. Në pikën III. Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.

Në arsyetim të aktvendimit të saj, gjykata e shkallës së parë ndër të tjera thekson se: Për të vlerësuar propozimin e paditësit/propozuesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit me nr.ref.14-57-13/2024 të datës 24.07.2024, të paditurës, Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Organizata Jo Qeveritare, gjykata iu referua nenit 22 par. 2 dhe 6 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative. Bazuar në dispozitat e lartcekura kjo gjykatë duke shqyrtuar kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestuese vlerësoi se, nga provat e bashkangjitura padisë dhe kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të atakuar me padi, gjeti se paditësi ka ofruar prova dhe argumente të besueshme se në rastin konkret janë përmbushur kushtet ligjore të parapara me dispozitën e nenit 22 të Ligjit nr.03/L-222 për Konfliktet Administrative, për shtyrje të ekzekutimit të vendimit. Deri tek ky konstatim gjykata erdhi pasi që analizoj provat e paraqitura nga paditësi, e ku përfshihen; lista e punëtorëve të regjistruar dhe të deklaruar në ATK e paditësit e datës 21.08.2024, nga ku shihet se paditësi për periudhën 07/2024 i ka 19 punëtor të regjistruar, pastaj Kontrata për Sigurim Shëndetësor dhe Aksidente Personale në Grup me nr. ..../... nga ku shihet se paditësja ka lidhur kontratë për sigurim shëndetësor dhe aksidente personale në grup me kompaninë e sigurimeve “S”. në P., Kontrata për Qiranë e lidhur me datë 01.08.2022 në mes të paditësit si qiramarrës dhe znj. F.I.B., si qiradhënës, e ku paditësi krahas detyrimit të pagesës së qirasë mujore që duhet ti paguar qiradhënëses, ka marr përsipër me kontratë të paguaj tatim në qira dhe tatimin në pronë, tek organet kompetente.

Gjykata bazuar në shkresat e lëndës vlerëson se ekzekutimi i vendimit të kontestuar me padi në rrethanat e aktuale do të mund ti shkaktonte paditësit dëme të cilat vështirë se do të riparoheshin, pasi që i njëjti është person juridik i pavarur dhe jo për përfitues, i themeluar për realizimin e qëllimeve të ligjshme për përfitim publik ose interes të ndërsjellë, për çka edhe e ka gëzuar Statusin për Përfitim Publik deri me revokimin e këtij statusi me vendimin e kontestuar. Duke e pasur këtë status, paditësi bazuar në Ligjin nr.06/L-043 për Lirinë e Asocimit në Organizata Qeveritare dhe ligjet tjera në fuqi, ka përfituar nga lirimi nga tatimi dhe lehtësira tatimore dhe fiskale, duke përfshirë lirimin nga pagesa e tatimit në pronë, lirimin nga tatimi në të ardhura personale, lirimi nga detyrimet importuese doganore dhe beneficione tjera të parapara me ligj.

Tutje thekson se: në momentin e ekzekutimit të vendimit të kontestuar me padi për revokimin e Statusit për Përfitim Publik të Organizatës Joqeveritare, paditësi do të detyrohet që në mënyrë retroaktive ti paguaj detyrimet tatimore dhe fiskale sipas legjislacionit në fuqi, dhe një obligim i tillë saktësohet me dispozite ne nenit 39 par.3 të Ligjit nr.06/L-043. Në të tilla rrethana paditësi do të gjendej në situatë të vështirë financiare, pasi që nuk është subjekt përfitues sipas ligjit dhe për pasoj do të mund të shkaktoheshin pasoja të cilat do ta afektonin ushtrimin e veprimtarisë së paditësit për çka është themeluar e që është mbështetja në zhvillimin e gjeneratave të ardhshme të rinjve që përdorin teknologjinë për të zbatuar zgjidhje inovative ndaj sfidave të zhvillimit lokal dhe kombëtar. Këto pasoja do të kishin ndikim pashmangshëm në subjektet të cilët përkrahën dhe mbështeten nga paditësi, për shkak se, në kushtet e pagesës së detyrimeve për të cilat paditësi deri me tani ka qenë i liruar për shkak të statusit si beneficues publik, paditësi nuk do të mund të operonte normalisht siç ka operuar gjer me tani, për shkak të mjeteve financiare në dispozicion. Për më tepër mos shtyrja e ekzekutimit të vendimit të kontestuar do të mund të kishte pasoja

reale jo vetëm në reduktimin e aktivitetit të paditësit por edhe në zvogëlimin e stafit të tij, respektivisht numrit të punëtorëve. Andaj në këtë rast në vlerësimin e gjykatës plotësohet kushti i parë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, e që është që nëse ekzekutohet vendimi i kontestuar, do ti sillte dëm paditësit, i cili dëm vështirë do të riparohej.

Gjykata e shkallës së parë, vlerëson se në rastin konkret plotësohet edhe kushti tjetër për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit e që është se shtyrja e ekzekutimit të vendimit të kontestuar me padi nuk është në kundërshtim me interesin publik e as nuk do ti sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtar, përkatësisht personit të interesuar. Kjo për shkak se, paditësi deri me nxjerrjen e vendimit të kontestuar për revokimin e Statusin për Përfitim Publik të OJQ-së nuk ka paguar detyrime tatimore dhe fiskale me përjashtim të tatimit të mbajtur në burim në paga dhe kontributet pensionale për punëtor, dhe se shtyrja e ekzekutimit të vendimit tani për tani nuk do të kishte ndryshim të gjendjes sa i përket buxhetit të shtetit. Në periudhën kohore kur gjykata do të vendos këtë çështje gjyqësore me vendim përfundimtar gjyqësor, pa paragjykuar vendimmarrjen e saj, paditësi do të duhej ti përmbushte detyrimet tatimore dhe fiskale për të cilat është liruar për shkak të statusit të Përfituesit Publik në pajtim me dispozitën e nenit 39 par.3 të Ligjit nr.06/L-043.

Gjykata thekson se shtyrja e vendimit të kontestuar nuk është në kundërshtim me interesin publik, përkundrazi, nga fakti se paditësi ushtron veprimtari në interes dhe të mirë të publikut, e që është mbështetja në zhvillimin e gjeneratave të ardhshme të rinjve që përdorin teknologjinë për të zbatuar zgjidhje inovative ndaj sfidave të zhvillimit lokal dhe kombëtar. Andaj gjykata vlerëson se e paditura duhet të pres nga ana gjykatës vendimin meritore, në mënyrë që nga e njëjta të vërtetohet se vendimi i nxjerr nga e paditura në procedurë administrative është i ligjshëm dhe i drejtë apo jo, në mënyrë që të mund të zbatohet më pastaj. Së këndejmi, gjykata vlerëson se në këtë rast janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet ligjore të kërkuara për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar të paditurës, të parapara me nenin 22 par.2 të LKA-së. Gjykata sa i përket dispozitivit III të këtij aktvendimi, me të cilin vendosi që ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi, këtë vendosje e bazoj në dispozitat e nenit 63 të LKA-së dhe nenin 310.4 të LPK-së.

Gjykata e Apelit në procedurë ankimore me aktvendimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur si në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), i aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, e aprovon si të bazuara ankesën e të paditurës - kundërpropozueses dhe ndryshon aktvendimin e shkallës së parë ashtu që e refuzon kërkesën e paditësit - propozuesit, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës. Në arsyetim pasi bënë përshkrimin e gjendjes së vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë lidhur me mënyrën së vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, andaj si i tillë nuk mund të pranohet, pasi që i njëjti është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave nga neni 182 paragrafi 2 nën paragrafi n), dhe nga neni 183 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Sipas vlerësimit të kolegjit të apelit, gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike,

e rrjedhimisht si pasojë e vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, ka rezultuar edhe aplikimi i gabuar i të drejtës materiale, përkatësisht neni 22 par. 2 të LKA-së. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar fare ose e ka vlerësuar gabimisht faktin se me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës mund ti shkactohet dëm i pa riparueshëm për shkakun, se i njëjti propozim nuk ka paraqitur asnjë provë ose kushte të cilat janë të parapara me ligj e të cilat e bëjnë të mundur shtyrjen e vendimit të kontestuar, e gjithashtu gabimisht e ka vlerësuar edhe faktin se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik.

Se arsyetimi i aktvendimit të ankimuar është i mangët lidhur me mos vlerësimin e fakteve vendimtare, siç është mundësia e shkaktimit të dëmit të riparueshëm apo në kundërshtim me interesin shoqëror, shihet qartë edhe nga arsyetimi i këtij aktvendimi e të cilat nuk kanë mundur të arsyetohen fare, e që e gjithë kjo bie në përfundim se gjykata e shkallës së parë, me rastin e vlerësimit të propozimit të paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestuese, nuk i ka vlerësuar fare faktet dhe provat, pasi që nuk janë paraqitur fare nga ana e propozuesit, në rastin konkret nga shkakun se me rastin e vlerësimit të propozimit për shtyrje, propozuesi është i obliguar që propozimin ta bazojë në prova të cilat do ta bënin të mundur shtyrjen e ekzekutimit, e të cilat prova dhe fakte nuk janë bërë nga propozuesi e nuk janë arsyetuar as nga ana e gjykatës.

Pas vlerësimit të fakteve të paraqitura, shkeljeve të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë, dhe pas përmbushjes së obligimit ligjor konform dispozitës së cekur më lartë, gjykata në bazë të provave të paraqitura të administruara dhe të vlerësuara nga ana e kolegjit, vlerësojë kërkesën e propozuesit lidhur me shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit dhe ankesën e të paditurës, dhe mori vendimin si në pikën III të dispozitivit, me që me asnjë provë nuk janë plotësuar kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit kontestuese të paditurit, ashtu siç kërkohet me neni 22 par. 2 dhe 6 të LKA-së. E gjithë kjo për shkakun se të gjitha pretendimet e paditësit në padi si dhe në propozim për shtyrje kanë të bëjnë me pretendimet lidhur me vendosjen në çështjen kryesore dhe të njëjtat nuk ndërlidhen fare me propozimin për shtyrje të ekzekutimit të vendimit.

Gjykata Supreme e Kosovës duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes si më lartë, vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, ekzaminimit të aktvendimit të kontestuar të gjykatës së shkallës së dytë dhe të parë si dhe shkresave tjera të lëndës vlerëson se, gjykata e shkallës së dytë ka vendosur drejtë dhe në baza ligjore me aprovimin si të bazuar të ankesës së paditurës-kundërpropozueses dhe ndryshimin e aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë. Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë me që aktvendimi i kontestuar nuk është i përfshirë me shkelje të esenciale të dispozitave nga neni 22 të LKA-së, dispozitave të LPK-së, e po ashtu nuk është bërë zbatim i gabuar i të drejtës materiale ashtu si pretendohet nga paditësi-propozuesi në kërkesë. Aktvendimi i kontestuar përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare dhe konkrete të vërtetuara sipas së cilave ka rezultuar se kërkesa e paditësit-propozuesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur është e pa bazuar.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate paditësi-propozuesi nuk ka arritur të dëshmojnë me prova bindëse mbështetjen e kërkesës së tij, se me ekzekutimin e vendimit të organit administrativ do ti shkactohej dëm i cili vështirë do të riparohej, që shtyrja-pezuillimi i ekzekutimit të vendimit të kontestuar nuk është në kundërshtim me interesin publik, dhe shtyrja nuk do ti shkaktonte dëm të pa riparueshëm apo të madh palës kundërshtare, përkatësisht palës së interesuar. Në çështjen juridike konkrete edhe sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, nga paditësi-propozuesi nuk janë plotësuar kushtet ligjore siç parashihen në nenin 22, të LKA-së në mënyrë kumulative të cilat janë të domosdoshme që pastaj gjykata të nxjerrë vendim për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit administrativ të paditur deri në vendosjen meritorë të çështjes sipas padisë me vendim të plotfuqishëm gjyqësor.

Pretendimet në kërkesë lidhur me shkaktimin e dëmit të riparueshëm, ku theksohet se: ekzekutimi i vendimit vë në pikëpyetje qarkullimin financiar, do të rrezikoj veprimtarinë e saj si OJQ, dhe kjo do të kishte pasoja reale për programet e saj dhe të punësuarit e saj, kolegji i Gjykatës Supreme i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson si të pa bazuara sepse nuk mbështeten me prova dhe fakte të argumentuara dhe konkrete që paditësit i shkaktohet dëm i cili vështirë do të riparohej nëse nuk shtyhet ekzekutimi i vendimit të organit të paditur deri në vendosjen meritorë të çështjes, andaj si të tilla nuk janë qëndrueshme, janë të përgjithësuara dhe pa mbështetjeje në fakte të argumentuara në prova, në bazë të cilave do të dëshmohej dëmi apo humbjet materiale vështirë të riparueshme.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, paditësi-propozuesi para gjykatës nuk ka prezantuar prova relevante mbi bazën e të cilës do të vërtetohej gjendja aktuale financiare, të ardhurat, pasuria dhe mjetet financiare të paditësit - propozuesit si dhe pamundësia e tij për përmbushjen e detyrimeve fiskale apo tatimore apo detyrimeve tjera. Gjykata Supreme vlerëson se si do që të vendoset çështja kryesore sipas padisë, do të jetë i mundur kompensimi sipas procedurave dhe mënyrave ligjore, ashtu që çfarëdo dëmi eventual që mund të pësojë paditësi - propozuesi do të jetë i riparueshëm, meqë bëhet fjalë për detyrimet të shprehura në vlerë monetare. Pretendimet e paditësit mbështeten kryesisht në fakte që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, lidhur kontestimin e ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, e cila nuk shqyrtohet në këtë fazë të vendosjes por në procedurë të rregullt gjatë vendosjes meritorë të çështjes pas shqyrtimit të provave dhe fakteve sipas padisë.

Pretendimet në kërkesë lidhur me interesin publik, dhe dëmin e mundshëm për palën kundërshtare përkatësisht personin e interesuar, ku theksohet ndër të tjera se: se shtyrja nuk dëmton buxhetin e shtetit në asnjë mënyrë, dhe se paditësja luan një rol të rëndësishëm në përparimin e shoqërisë kosovare, nëpërmes aktiviteteve që promovojnë edukimin joformal në fushën e teknologjisë, emancipimit të vajzave dhe përfshirjen e të rinjve në komunitet, zhvillimin social dhe ekonomik të vendit, kolegji i Gjykatës Supreme i vlerëson si të pabazuara dhe të paqëndrueshme ngase të njëjtat kanë të bëjnë me tepër me çështjen kryesore se sa me vendosjen për kërkesën lidhur me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit.

Lidhur me pretendimet në kërkesë të paditësit - propozuesit, për shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 paragraf 2 pika n), neni 160 paragraf 4 dhe 5 dhe neni 173 të LPK-së, kolegji i Gjykatës Supreme i refuzon po ashtu si të pabazuara dhe jo të qëndrueshme. Aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë është vendim i drejtë dhe ligjor, dhe i arsyetuar mjaftueshëm lidhur me faktet vendimtare duke dhënë vlerësime përkatëse për pretendimet e paraqitura nga palët, ashtu siç parashihet në nenin 22 të LKA-së, për aq sa është e domosdoshme të arsyetohet mënyra e vendosjes për kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit sipas provave të ofruara, gjithnjë duke u kujdesur që mënyra e vendosjes për kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit dhe arsyetimi i vendimmarrjes të mos e prejduktoj mënyrën e vendosjes së çështjes kryesore nga gjykata sipas padisë.

Gjykata shqyrtoj edhe pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës, por vlerësoj se të njëjtat janë shqyrtuar nga gjykata e shkallës së dytë, të njëjtat janë të pabazuara, të paqëndrueshme dhe të pa argumentuara, për vendosjen ndryshe në këtë çështje nga ajo e vendosur nga kjo gjykatë. Edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë përmban të meta, pasi faktet vendimtare janë të paqarta dhe kontradiktore duke mos u mbështetur në prova dhe fakte të pa argumentuara andaj rezultojnë i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të nenit 181 par.1 e lidhur me nenin 182 par. 2 pika (n) të LPK-së, prandaj qëndrimi juridik i kësaj gjykate nuk është i drejtë dhe i ligjshëm dhe si i tillë nuk mund të pranohet. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së dytë ka vepruar në baza ligjore me refuzimin e kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të të paditurës, duke ndryshuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të saj.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 54, par.1, lidhur me nenin 22, par.2 dhe 6, të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA SUPREME - PRISHTINË**  
ARJ nr.279/2024, me datë 23 Dhjetor 2024

B. Profesionale,  
Zanë Buçinca

Kryetari i kolegjit,  
Ragip Namani